




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



Për/Za/To:	Subjektet e autorizuar për organizimin e aktiviteteve të EVP-së: • Institucionet e arsimit të lartë, të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; • Institucionet shëndetësore të tri niveleve të kujdesit shëndetësor; • Shoqatat profesionale të infermierëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të OIK; • Subjektet biznesore që kanë të regjistruar veprimtarinë në fushën e profesionistëve shëndetësorë të OIK-ut; • OJQ-të dhe subjektet ndërkombëtare, veprimtaria e të cilave është e ndërlidhur me sistemin shëndetësor; • Odat e tjera të profesionistëve shëndetësorë.
CC	Këshilli Drejtues i OIK
Nga /Od /From:	Znj. Nexhmije Gori- Kryetare e OIK
Tema / Subjekat / Subject:	Dërgimi i propozimeve për planin vjetor të programeve të EVP për vitin 2026
Datë / Datum / Date:	09.10.2025

Të nderuar/a,

Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës (OIK) njofton të gjitha subjektet e autorizuar për organizimin e aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), të parapara me nenin 9 të Rregullores për EVP, Nr. prot. 247, datë 25.08.2025, se kanë obligim të përgatisin Planin Vjetor të Programeve të EVP-së për vitin vijues – 2026.

Plani duhet të hartohet në përputhje me nenin 10 të Rregullores për EVP, ndërsa pas pranimit të propozimeve nga subjektet përkatëse, Këshilli Drejtues i OIK do të përcaktojë modalitetet dhe temat përfundimtare të EVP-së për vitin 2026.

Rrjedhimisht, të gjitha programet dhe subjektet e autorizuar duhet të sigurohen që propozimet e tyre për akreditim të programeve të jenë brenda listës së temave të miratuara nga Këshilli Drejtues i OIK.

Prandaj, nga ju kërkohet që të:

- analizoni nevojat reale për Edukim të Vazhdueshëm Profesional,
- shqyrtoni planet tuaja institucionale për vitin 2026, dhe
- të dërgoni propozimet e programeve në Zyrën për EVP të OIK, më së largu deri më datën 30 tetor 2025.

Kjo qasje dhe këto obligime, përveç karakterit të tyre normativ, kanë për qëllim krijimin e një rendi dhe prioriteti në fushën e EVP-së, duke u fokusuar në temat dhe çështjet që reflektojnë nevojat reale të sistemit shëndetësor në Kosovë dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm të profesionistëve shëndetësorë.

Ftojmë të gjitha institucionet që të dërgojnë në formë zyrtare propozimet e tyre, të cilat duhet të jenë të nënshkruara Udhëheqësi përkatës i institucionit dhe nga Kryeinfermieri/Koordinatori i/e EVP-së.

Propozimet mund të dorëzohen në formë fizike në Zyrën për EVP të OIK-ut, ose në formë elektronike në adresën e emailit: evp@oik-ks.org

Me respekt,
Nexhmije Gori
Kryetare e OIK

